



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Në bazë të nenit 58, paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare nr.28/2008, lidhur me nenin 50 pika l të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës, me datën 11.03.2020 bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

**Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE)
2019-2021**

Neni I

Objekti i përgjithshëm i planit të veprimit për eficiencë të Energjisë 2019-2021 është zvoglimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të konfortit dhe ulja e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin komunal të Komunës së Vitisë.

Neni II

Përfitimet që priten nga zbatimi i PKVEE janë të natyrës financiare, mjedisore dhe operationale. Si të tilla shpenzime numrohen kursimet në buxhetin komunal që vijnë nga zvoglimi i konsumit të energjisë si dhe zvoglimi i lëndës së shtrejtë për prodhimin e energjisë me lëndë që kushton më pak por edhe nuk ndotë mjedisin.

Neni III

Udhëzimi administrativ QRK NR.09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë si akt nënligjor rregullon pozitën dhe detyrat e zyreve komunale të energjisë.

Neni IV

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës

Neni V

Ky propozim vendim fuqizohet në ditën e miratimit në Kuvendin Komunal të Vitisë.

Propozues,

Kryetari i Komunës

z.Sokol Haliti



KOMUNA E VITISË

Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019 – 2021

Shtator 2019



Implemented by
giz
Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Deklarim:

Ky Plan është mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe implementuar përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Studimi, mbledhja e të dhënave dhe hartimi i planit është realizuar nga Studio Links 4. Pikëpamjet e hartueseve të këtij plani (Studio Links 4) si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

DRAFT TEMPLATE

Shkurtesat:

GIZ	Agjencia gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar
MZHE	Ministria e zhvillimit ekonomik
AKEE	Agjencia e Kosovës për efikasitet të energjisë
PKVEE	Plani komunal i veprimeve për efikasitet të energjisë
PKEE	Plani komunal i efikasitetit të energjisë
kWh	Kilovat orë
kWh/m ² v	Kilovat orë për metër katror në vit
LED	Ndriçimi me dioda emetuese
MWh	Megavat orë
N A	Nuk aplikohet
ktoe	Kilo ton oil ekuivalent
KEDS	Kompania për shpërndarje dhe furnizim me energji
KAB	Korniza afatmesme buxhetore
EE	Efikasiteti i energjisë
IPCC	Paneli ndërqeveritar për ndryshimet klimatike

1. HYRJE.....	7
1.1. KONTEKSTI.....	8
	3

1.1.1. OBJEKTIVAT E PKVEE.....	9
1.1.2. KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKAT.....	9
1.1.3. PËRFITIMET E PRITURA NGA PKVEE.....	10
1.2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	10
1.2.1. POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË.....	11
2. INFORMATAT BAZË PËR KOMUNËN.....	13
2.1. POZITA DHE TOPOGRAFIA.....	13
2.2. KLIMA.....	13
2.3. POPULLATA DHE VENDBANIMET.....	14
2.4. STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	15
2.5. INDIKATORËT EKONOMIK DHE FINANCIAR.....	15
2.6. NDËRLIDHJA ME POLITIKAT LOKALE, NACIONALE DHE TË TJERA.....	17
2.7. PËRVOJA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË.....	18
2.7.1. KAPACITETET PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE.....	18
3. FURNIZIMI ME ENERGJI, PRODHIMI DHE DISTRIBUIMI.....	18
3.1. FURNIZIMI ME ENERGJI.....	18
3.1.1. ENERGJIA ELEKTRIKE.....	19
3.1.1.1. Furnizimi me energji elektrike.....	20
3.1.1.2. Distribrimi i energjisë elektrike.....	20
3.1.2. DERIVATET E NAFTËS.....	20
3.1.2.1. Nafta.....	20
3.1.2.2. Benzina.....	20
3.1.2.3. Mazut.....	21
3.1.2.4. LPG.....	21
3.1.3. THËNGJILLI.....	21
3.1.4. BIOMASË DRURI.....	21
3.1.4.1. Dru zjarri.....	21
3.1.4.2. Pelet.....	22
3.1.4.3. Tjera.....	22
3.2. PRODHIMI I ENERGJISË.....	22
3.2.1. PRODHIMI I ENERGJISË PREJ BURIMEVE TË RIPËRTRITSHME (PANELE DIELLORE FOTOVOLTAIKE, PANELE DIELLORE TERMALË, POMPA TË NXEHTËSISË, ERA).....	22
3.2.2. PRODHIMI I ENERGJISË PËR NGROHJE QENDRORE TE QYTETIT.....	22
3.3. PRODHIMI I ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE.....	22
3.3.1. PRODHIMI I ENERGJISË NË EKONOMITË FAMILJARE (NDËRTESAT E BANIMIT).....	23
3.3.2. PRODHIMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE.....	23
3.3.2.1. Prodhimi i energjisë në ndërtesa komunale.....	24
3.3.2.2. Prodhimi i energjisë në sektori komercial, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.....	24
3.3.2.3. Prodhimi i energjisë në shërbimet publike.....	24
3.3.3. PRODHIMI I ENERGJISË NË INDUSTRI.....	24
3.3.4. PRODHIMI I ENERGJISË NË BUJQËSI.....	24
3.3.5. LËNDË TJERA PËR PRODHIMIN E ENERGJISË.....	24
4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE.....	25
4.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT PUBLIKE.....	25
4.1.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT ADMINISTRATIVE.....	27
4.1.2. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË.....	28
4.1.3. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT E NËN-SEKTORIT TË SHËNDETËSISË.....	31
4.1.4. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT E KULTURËS E SPORTIT.....	32

4.1.5. KONSUMI I ENERGJISË TE NDRIÇIMI PUBLIK	33
4.1.6. ANALIZA E STOKUT NDËRTIMOR	35
4.1.1. TË TJERA	36
4.2. KONSUMI I ENERGJISË NË SHËRBIMET PUBLIKE	37
4.2.1. KONSUMI I ENERGJISË NË FURNIZIMIN ME UJË DHE SEKTORIN E UJËRAVE TË ZEZA	37
4.3. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E BUJQËSISË	37
4.4. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E MBLEDHJES SË MBETURINAVE	37
4.5. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT	37
4.5.1. FLOTA E AUTOMJETEVE KOMUNALE	38
4.5.2. TRANSPORTI PUBLIK	38
4.6. KONSUMI I PËRGJITHSHËM I ENERGJISË	38
5. ANALIZA E POTENCIALIT TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE	39
5.1. SEKTORI I SHËRBIMEVE	39
5.1.1. NDËRTESAT PUBLIKE	39
5.1.1.1. Ndërtesat e administratës	40
5.1.1.2. Ndërtesat e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	40
5.1.1.3. Ndërtesat e mjekësisë familjare	42
5.1.1.4. KULTURA DHE SPORTI	42
5.1.1.5. Ndriçimi publik	43
5.2. SHËRBIMET KOMUNALE	43
5.2.1. SHËRBIMET PUBLIKE	43
5.3. BUJQËSIA	43
5.4. TRANSPORTI	43
5.4.1. FLOTA KOMUNALE	44
5.4.2. TRANSPORTI KOMUNAL	44
5.4.3. POTENCIALI I KURSIMIT NGA SEKTORËT TJERË	44
6. POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË	44
7. ANALIZA E EMETIMEVE TË GAZRAVE SERË DHE POTENCIALI PËR KURSIM	45
8. CAQET E KURSIMIT TË ENERGJISË	46
9. MASAT E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË PËR TË ARRIT CAQET E KURSIMIT	47
9.1. INFORMIMI DHE MASAT PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE	47
9.1.1. MASAT PËR POLITIKAT KOMUNALE, PROMOVIM DHE NDRYSHIM TË SHPREHIVE	47
9.2. EFIÇIENCA ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE	49
9.2.1. masat E efiçencës së energjisë në sektorin publik	49
9.2.1.1. SEKTORI I ADMINISTRATËS	50
9.2.1.2. Ndërtesat e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	50
9.2.1.3. Sektori i shëndetësisë	54
9.2.1.4. Sektori i kulturës dhe sportit	56
9.2.1.5. Ndriçimi publik	56
9.2.1. SHËRBIMET PUBLIKE	56
9.3. BUJQËSIA	57
9.4. TRANSPORTI	57
9.4.1. FLOTA KOMUNALE DHE TRANSPORTI PUBLIK	57
10. PLANI I VEPRIMIT	58
10.1. ZBATIMI I MASAVE TË POLITIKAVE LOCALE, TË PROMOVIMIT DHE NDRYSHIMIT TË SHPREHIVE E SJELLJES	58
10.2. ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK	1
10.3. ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SHËRBIMET PUBLIK	2

10.4. ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË BUJQËSI	2
10.5. ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË TRANSPORT	2
11. MONITORIMI DHE IMPLEMENTIMI I PLANIT TË VEPRIMIT	1
11.1. MENAXHIMI I ENERGJISË KOMUNALE	1
11.2. KOORDINIMI	1
11.3. RAPORTIMI	2
11.3.1. MONITORIMI DHE RAPORTIMI BRENDA KOMUNËS	2
11.3.2. RAPORTIMI NË NIVELIN QENDROR (AKEE).....	2
12. MODELI DHE BURIMET E FINANCIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË	3
12.1. FINANCIMI NGA BUXHETI KOMUNAL	3
12.2. FINANCIMI NGA BUXHETI QENDROR	3
12.3. FINANCIMI NGA DONATORËT	3
12.4. FINANCIMI NGA FONDET E BE	3
13. KONKLuzionET	4
14. REFERENCAT	5

Tabela 1 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike	11
Tabela 2 - Masat e rekomanduara kumulative	12
Tabela 3 - Të dhëna me rëndësi për komunën e Vitisë	14
Tabela 4 - Buxheti i Komunës së Vitisë	16
Tabela 5 - Buxheti i Komunës së Vitisë(Euro)	16
Tabela 7 - Sasia e energjisë së konsumuar sipas burimeve energjetike mesatare 3 vite në sektorin e ndërtesave	19
Tabela 9. Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike	23
Tabela 10 - Konsumi i energjisë sipas sektorëve, për vitin 2018	25
Tabela 11 - Gjendja fizike e stokut ndërtimor	26
Tabela 12 - Konsumi i energjisë në ndërtesat administrative	27
Tabela 13 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e nën-sektorit të arsimit	28
Tabela 14 - Shkollat me numër të nxënësve nën 84	30
Tabela 15 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e shëndetësisë	31
Tabela 16 - Konsumi i energjisë në ndërtesat për kulturë e sport	32
Tabela 17 - Llojet e llambave dhe kapaciteti i instaluar	34
Tabela 18 - Llojet e llambave, konsumi vjetor dhe kapaciteti i instaluar	34
Tabela 19 - Konsumi i përgjithshëm sipas nën-sektorëve	35
Tabela 20 - Kumulativi i konsumit të energjisë në komunë	38
Tabela 21 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike	40
Tabela 22 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Administratës	40
Tabela 23 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e arsimit, shkencës e teknologjisë	41
Tabela 24 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Shëndetësisë	42
Tabela 25 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Kulturës dhe Sportit	42
Tabela 26 - Llogaritja e potencialit të kursimit të sektori i ndriçimit publik	43
Tabela 27 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim	45
Tabela 28 - Faktorët e emisioneve të përdorura për përcaktimin e emisioneve të CO ₂	45
Tabela 29 - Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike mesatare për tri vite	46
Tabela 30 - Kumulativi i konsumit të energjisë	46
Tabela 31 - Masat e propozuara për politika lokale, promovim dhe ndryshim të shprehive të sjelljes	58
Tabela 32 - Përmbledhje e masave dhe veprimeve	4
Figura 1. Organogrami i Komunës së Vitisë	15
Figura 2 - Shpenzimet për energji dhe sipas sektorëve	17
Figura 3 - Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike me përqindje	24
Figura 4 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e administratës	28
Figura 5. Energjia specifike në ndërtesat e nën-sektorit të arsimit	30
Figura 6. Konsumi specifik i energjisë të ndërtesat shëndetësore	32
Figura 7 - Konsumi specifik i energjisë të ndërtesat e kulturës dhe sportit	33

1. HYRJE

Bazuar në Direktivën për Eficiencën e Energjisë 2012/27/BE, që ka hyrë në fuqi më 5 dhjetor 2012, Bashkimi Evropian ka vendosur objektiva për reduktimin e konsumit të energjisë primare në 20% deri në vitin 2020. Të gjitha aktivitetet e institucioneve relevante në sektorin e energjisë rrjedhin nga nevojat për të përmbushur kërkesat e energjisë të vendit dhe përmbushjen e detyrimeve nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Republika e Kosovës si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë është përcaktuar të kontribuoj në arritjen e objektivave të eficiencës së energjisë, duke krijuar stimuj për kursimin e energjisë nga qytetarët, gjithashtu për hapjen e tregjeve dhe bizneseve të reja për aplikimin e teknologjive dhe shërbimeve efikase për energji.

Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë në Kosovë ((2010-2018)) është dokument bazik për implementimin e politikave për eficiencë të energjisë në Kosovë I miratuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik më 30 shtator 2011. Ai parasheh arritjen e cakut indikativ prej 9% të 1021.08 ktoe deri në fund të periudhës së mbuluar me plan (2010-2018). Prandaj, sasia e energjisë që Kosova synon të kursejë deri në vitin 2018 është 91.89 ktoe. Bazuar në konsumin aktual për periudhën afatshkurtër në fushën e kursimit të energjisë objektivi më i lartë është vendosur në sektorin e amvisërisë me 40% duke u pasuar nga sektori i shërbimeve me 30%. Përveç këtij aspekti, sektori i shërbimeve ka rol të rëndësishëm edhe për faktin se shumica e konsumatorëve të këtij sektori i takon sektorit publik, ndërsa sipas Direktivës 2006/32 / EC ky sektor duhet të jetë sektori kryesor drejt përmirësimit të kursimit të energjisë. Kjo do të thotë se përmirësimi i kursimit të energjisë në këtë sektor është thelbësor për të arritur objektivin përkatës në nivel vendi. Prandaj, hulumtimi i situatës aktuale dhe mbledhja e të dhënave gjithëpërfshirëse për konsumin e energjisë, parashikimi i kërkesës, ofrimi i mundësive alternative për përmbushjen e nevojave dhe identifikimi i mundësive për kursimin e energjisë në këtë sektor paraqet qëllimin kryesor të këtij Plani.

Në bazë të rritjes së zhvillimit ekonomik është paraqitur edhe rritja e konsumit të energjisë që kërkon nga qeveritë vendore që të ndërmarrin masa për kursimin e energjisë ose identifikimin e burimeve të ripërtritshme për gjenerimin e energjisë.

Për të arritur caqet e nivelit nacional, komunat duhet të ndërmarrin plane konkrete ku do të identifikonin situatën aktuale të konsumit të energjisë, shpenzuesit më të mëdhenj, potenciali më i mirë për kursim si dhe masat e mundshme nëpërmjet projekteve konkrete.

PVKEE është një mjet që mund të ndihmojë komunat për një planifikim të tillë.

1.1. KONTEKSTI

Në vazhden e aktiviteteve për arritjen e caqeve për kursim të energjisë në nivel nacional, Komuna e Vitisë me ndihmën e GIZ-it gjerman, janë zotuar që të përgatisin PKVEE.

Komuna e Vitisë, pas hartimit të PKEE 2015-2020, me përkrahjen e GIZ-it Gjerman me Pilot Projektin GIZ-KEEP "Krijimi i sistemit për menaxhim të energjisë në nivel lokal" zotohet në hartimin e Planit të Veprimit Komunal për Eficiencë të Energjisë duke e përcjell me projektin përcjellës për Krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Energjisë në Nivel Lokal.

1.1.1. OBJEKTIVAT E PKVEE

Objektivi i përgjithshëm i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të KOMFORIT dhe ulja e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin komunal të Komunës së Vitisë.

Në gjendjen e Komunës së Vitisë pritet që PKVEE të ketë ndikimet e mëposhtme:

Në gjendjen e Komunës së Vitisë pritet që PKVEE të ketë ndikimet e mëposhtme:

- Zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorët e ndërtimit të ndërtesave, transportit dhe ndriçimit publik;
- Kursimi i buxhetit komunal duke ofruar shërbime më efikase të energjisë;
- Përmirësimi i shërbimeve komunale dhe ngritja e efikasitetit në operim;
- Përmirësimi i kushteve sanitare dhe nivelit të rehatisë (komfortit) në ndërtesat publike;
- Zvogëlimi i emetimeve të CO₂ në të gjithë sektorët duke zbatuar masat e efikasitetit të energjisë, duke përdorur burimet e ripërtëritshme të energjisë, duke menaxhuar konsumin, përmes trajnimit dhe masave të tjera;
- Ngritja e vetëdijes e kreatorëve të politikave për kursim të energjisë, operatorëve dhe përdoruesve përfundimtarë.

1.1.2. KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKAT

LIGJI I RI PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË (Ligji Nr. 06/L -079), miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Nëntor të vitit 2018, **Neni 6 - Planet Komunale të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, zbatimi dhe raportimi**, përshkruan përgjegjësitë e Zyrave Komunale të Energjisë në zhvillimin e Planeve Komunale të Eficiencës së Energjisë dhe Raporteve të Progresit të Zbatimit të Planit Komunal të Eficiencës së Energjisë, sipas udhëzimeve të Agjencionit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë - AKEE. Të dy dokumentet duhet të miratohen nga Kuvendi Komunal dhe më pas të dorëzohen në AKEE.

LIGJI I RI PËR ENERGJINË (LIGJI Nr. 05/L -081) - Neni 9- Roli i qeverisjes lokale thotë se Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë dhe Programin për Zbatimin e Strategjisë, si dhe bilanceve të energjisë.

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) Nr. 09/2017, datë 6 shtator 2017, PËR ZYRAT E ENERGJISË KOMUNALE - përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave komunale të

energjisë për të adresuar çështjet e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave energjetike në nivel lokal. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të Zyrave Komunale të Energjisë më poshtë janë shënuar përgjegjësitë kryesore:

- të krijojë një bazë të dhënash dhe të mbajë një sistem informacioni për grumbullimin e rregullt të të dhënave për konsumin e energjisë në baza periodike, shpenzimet e energjisë dhe të dhëna të tjera relevante duke mbajtur një regjistër që mundëson përzgjedhjen e indikatorëve potencial të eficiencës së energjisë për ndërtesat komunale energjetike,
- të raportojë për zbatimin e PKVEE, dhe zhvillimet e pritshme në pjesën e mbetur të Programit,
- të zhvilloj aktivitetet e planifikimit të sektorit të energjisë, bazuar në Strategjinë e Energjisë, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komunave,
- të sigurojë të dhënat e nevojshme për Ministrinë përkatëse për përgatitjen e PKVEE-it, rishikimin dhe përgatitjen e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për tre (3) vjet në pajtim me Ligjin për Energjinë,
- të monitorojë vazhdimisht zbatimin e PKVEE në nivelin komunal dhe t'i raportojë Ministrisë për zbatimin e tij

1.1.3. PËRFITIMET E PRITURA NGA PKVEE

Përfitimet që priten nga zbatimi i PKVEE janë të natyrës financiare, mjedisore dhe operacionale. Si të tilla do të numërohen kursimet në buxhetin komunal që vijnë nga zvoglimi i konsumit të energjisë si dhe zëvendësimi i lëndës së shtrenjt për prodhimin e energjisë me lëndë që kushton më pak por edhe nuk ndot mjedisin .

1.2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PKVEE jep informacion mbi konsumin e energjisë në stokun e ndërtesave komunale - ndërtesat administrative, arsimore dhe shëndetësore, sektorin e ndriçimit rrugor dhe flotën e automjeteve komunale. Përmban synime, prioritetë dhe afate specifike. Ky plan përfshin përdorimin e energjisë, disponueshmërinë e burimeve dhe reduktimin e emetimeve që shkaktojnë probleme të ndryshmeve klimatike. PKVEE tregon zonën që do të ndikohet si: kursime potenciale në stokun e ndërtesave të sektorit e arsimit në nivel komunal. Plani përfshin gjithashtu një plan zbatimi, identifikimi i masave adekuate me kursimet e mundshme të parashikuara dhe vlerësimet e nevojshme të parashikuara.

Me zhvillimin e këtij Plani Komunal të Eficiencës së Energjisë, Komuna e Vitisë promovon një strategji të qëndrueshme afatgjatë dhe një plan specifik për arritjen e objektivave mjedisore dhe ekonomike. E rëndësishme së veçantë është vlerësimi i potencialit të kursimit dhe sektorët me potencial më të madh.

1.2.1. POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË

Potenciali për kursim të energjisë është analizuar në dy sektorë: Stokun e ndërtesave komunale në komunën e Vitisë që përbëhet nga ndryshime / përmirësime realisht të arritshme duke krahasuar konsumin aktual të energjisë dhe konsumin e energjisë pas zbatimit të masave të qëndrueshme të eficiencës së energjisë dhe Ndriçimin Publik në Komunën e Vitisë që përfshinë ndrrimin e llambave të Zhivës me Llamba LED.

Vlera e potencialit për eficiencë energjetike është përcaktuar nga parametrat e mëposhtëm:

- Kushtet aktuale,
- Investimet e nevojshme,
- Niveli real i zbatimit të masave të eficiencës së energjisë.

Potenciali për kursimin e energjisë është si më poshtë:

Tabela 1 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike

Sektori	Kursimet [MWh/ vit]	Investime per tri vite [EUR]	Kursimet CO ₂ [tCO ₂ vit]
Politika komunale, promovim	/	110,000	/
Ndërtesat komunale	803	1,342,000	71
Ndriçim publik	7.7	23,000	11
Gjithsej	836	1,475,000	82

Meqë i tërë sistemi i ndriçimit publik tanimë është me llamba eficiente, nuk parashihet ndonjë potencial në kursimin e energjisë nga investimet në Ndriçimin publik apo transportin publik.

POTENCIALI I KURSIMIT SIPAS PKVEE

Dokumenti identifikon masat për ngritje kapacitetesh dhe vetëdijësim të banorëve të Komunës së Vitisë për rëndësinë e kursimit të Energjisë, masat për renovime të stokut të ndërtesave publike sipas radhës së përcaktuara në bazë të kriterëve të përvetësuar, masat për deponim qendrorë të biomasës dhe prezanton Planin e Veprimit me masa konkrete.

Efektet e masave të rekomanduara rezultojnë me vlerat sikur në tabelën në vijim.

Tabela 2 -Masat e rekomanduara kumulative

Sektori		Kursimet [MWh/ vit]	Investime per tri vite [EUR]	Kursimet CO ₂ [tCO ₂ vit]
Politika komunale, promovim		/	110,000	/
Ndërtesat komunale		731	1,314,000	74
Ndriçim publik		7.7	23,000	11
Gjithsej		836	1,447,000	85

2. INFORMATAT BAZË PËR KOMUNËN

2.1. POZITA DHE TOPOGRAFIA

Komuna e Vitisë, me një sipërfaqe prej rreth 270 km², shtrihet në juglindje të Republikës së Kosovës. Në verilindje kufizohet me komunën e Gjilanit, në perëndim me komunën e Ferizajt, në jugperëndim me komunën e Kaçanikut dhe krejtësisht në juglindje kufizohet me Republikën e Maqedonisë.

Kjo komunë ka 39 vendbanime, 38 fshatra dhe qyteti i Vitisë.

Komuna e Vitisë sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 ka 7496 banesa(shtëpi), 7520 ekonomi familjare dhe 46987 banorë¹.

INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Infrastruktura rrugore

Transporti në Viti, kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike. Në mungesë të transportit përmes hekurudhës, sidomos të mallrave me tonazh të lartë, rrugët automobilistike ngarkohen së tepërmi dhe kështu vie deri te dëmtimi i tyre.

Rrjeti i ujësjellësit

Në qytetin e Vitisë dhe në disa fshatra, ka sisteme të instaluar të ujësjellësve. Përkundër kësaj, sipas informative të organeve kompetente në Viti, vetëm **97%** e popullatës urbane është e kyçur në rrjetin publik të furnizimit me ujë¹⁴. Siç shihet nga lart, vetëm banorët të cilët janë duke banuar në qytet furnizohen me ujë nga rrjeti qendror i ujësjellësit dhe sipas informatave jo të gjithë banorët e qytetit. Për shkak të mungesës së ujit, ka reduktime të rregullta (**5 orë/ditë**). Humbjet teknike dhe administrative në sistemin e ujësjellësit, janë shumë të mëdha (mesatarja e humbjeve është rreth **40 %**).²

Furnizimi me energji elektrike

Vitia me rrethinë, furnizohet nga linja e transmisionit 110 kV, e cila është e nisur nga trafostacioni Prishtina-4, e cila pastaj vie në trafostacionin e Gjilanit vazhdon, dhe arrin në Viti, saktësisht në fshatin Ramnishtë të komunës së Vitisë. Pastaj kjo linjë 110 kV, vazhdon për Sharr nga fshati Ramnishtë i Vitisë.

2.2. KLIMA

Klima në komunën e Vitisë ndryshon edhe në pjesët e ndryshme të vendit, në pjesët jug-perëndimore të Vitisë kemi temperatura më të ulëta (për 0.5 Co) të reshura më pak, kurse

¹ PKEE Viti 2016-2020

² PZHU Viti

në pjesën veri-lindore ku shtrihet lugina e lumit Morava e Binçës parametrat klimatik ndryshojnë³

2.3. POPULLATA DHE VENDBANIMET

Qyteti i Vitisë, gjendet në pjesën juglindore të Kosovës, regjionin e Anamoravës, në qendër të Komunës së Vitisë, me një sipërfaqe prej, **10.785 km²**. Në veri-lindje kufizohet me komunën e Klokotit, në veri-perëndim me fshatin Pozheran, në perëndim me fshatrat Drobeshin dhe Gërmovë. Në jugë-perëndim me fshatin Smirë, në jugë me fshatrat Kabash dhe Binçë, në jug-lindje me fshatin Beguncë dhe në lindje, me fshatin Ramnishtë. Gjatësia e vijës kufitare e komunës është, **18.96 km**. Sipërfaqja e ndërtuar aktualisht në qytetin e Vitisë, përfshinë një sipërfaqe prej, **169.64 ha**.

Sipas madhësisë demografike, qyteti i Vitisë mund të kategorizohet, në: vendbanimet e karakterit urban. Në bazë të dhënave të fundit nga grupet punuese për përgatitjen e Planit Zhvëllimor Urban (grupit për demografi dhe çështje sociale), në komunën e Vitisë për vitin 2010, vendbanimin e Vitisë e kategorizon në kategorinë e katërt të vendbanimeve të madhësisë me mbi 5000 banor, dhe në këtë drejtim janë 2 vendbanime: Pozherani me 6820 banorë, dhe Vitia me 8000 banor.⁴Të dhëna të rëndësishme gjeografike e demografike janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 3 - Të dhëna me rëndësi për komunën e Vitisë

<u>Komuna</u>	<u>Viti</u>
<u>Adresa</u>	Rr. 28 Nëntori.
<u>Regjioni</u>	<u>Gjilan</u>
<u>Kodi postal</u>	61000 Viti
<u>Ueb faqja</u>	www.kk.rks.gov.net/Viti
<u>Sipërfaqja</u>	<u>270km²</u>
<u>Numri i fshatrave/vendbanimeve</u>	<u>38/39</u>
<u>Numri i popullsisë</u>	<u>46987 banorë</u>
<u>Numri i ekonomive familjare</u>	<u>7520</u>
<u>Popullsia në zona urbane</u>	<u>8000 banorë</u>
<u>Klima</u>	<u>Kontinentale</u>
<u>Gjatësia e sezonit të ngrohjes</u>	<u>185 ditë</u>

³ PZHK Viti

⁴ PZHU Viti

2.4. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Struktura organizative e Komunës së Vitisë është paraqitur në organogramin e mëposhtëm.




Figura 1. Organogrami i Komunës së Vitisë

Komuna e Vitisë ka emëruar Menaxherin e zyrës për energji, z. Xhelal Musa. Të dhënat e përgjithshme për komunën në këtë dokument janë siguruar nga ueb faqja e Komunës së Vitisë dhe zyrtarët përgjegjës

2.5. INDIKATORËT EKONOMIK DHE FINANCIAR

Komuna e Vitisë ka të hartuar dhe aprovuar Kornizën afatmesme buxhetore (KAB) për vitin 2019-2021. Të hyrat komunale të komunës Viti realizohen në bazë të Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale. Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të

hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim⁵

Buxheti komunal sipas këtij dokumenti është dhënë në figurën më poshtë:

Kategorite ekonomike	V.2018	V.2019	V.2020	V.2021
Pagesat dhe shtesat	7203838	7,309,561	7,280,342	7,411,985
Mallrat dhe shërbimet	1281874	1,481,703	1,381,550	1,371,889
Huamarrja në shëndetësi-mallra dhe shërbime	112,769	112,769		
Shpenzimet komunale	200,862	221,000,	222,800	236,138
Subvencione dhe transfere	197,712	210,000	237,572	238,138
Shpenzime kapitale	2,213,699	2,123,287	2,526,203	2,923,829
Totali EURO	11,097,987	11,345,551	11,748,467	12,182,641

Tabela 4 - Buxheti i Komunës së Vitisë

Shpenzimet për energji llogariten duke përdorur konsumin e energjisë të raportuar nga komuna dhe çmimet mesatare specifike të karburanteve dhe energjisë elektrike.

Tabela 5 - Buxheti i Komunës së Vitisë(Euro)⁶

Viti	2018
Buxheti total	€ 11,097,987
Fatura e përgjithshme e energjisë	€ 224,171 (pa transport)
Ndërtesat publike – (përfsh. Ene. Elektrike, termike)	€ 184,799
Ndriçimi publik	€ 39,372
Automjetet e komunës (karburantet)	Nuk ka të dhëna

Fatura e energjisë së komunës së Vitisë në kategorizimin e shpenzimeve ndahet mes kategorisë „Mallra dhe shpenzime“ dhe kategorisë „Shpenzime komunale“. Në tërësi buxheti i planifikuar për këto dy kategori bashkë është €1,482,736 ndërsa shpenzimet për energji arrijnë 15% të kësaj vlere

Shpenzimet komunale për lëndë djegëse, karburante dhe energji elektrike për vitin e kaluar raportues shprehur në terma financiar mund të gjenden në grafikun e mëposhtëm.

⁵ Korniza afatmesme buxhetore 2019-2021

⁶ Burimi i informatare-Komuna e Shtimes




Figura 2 - Shpenzimet për energji dhe sipas sektorëve

2.6. NDËRLIDHJA ME POLITIKAT LOKALE, NACIONALE DHE TË TJERA

Ky dokument ndërlidhet me politikat tjera relevante lokale, nacionale dhe ndërkombëtare.

LIGJI Nr. 06/L -079 PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË tek Neni 1- Qëllimi përcakton kornizën ligjore të domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e efijencës së energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të përcaktimit të caqeve të efijencës së energjisë dhe arritjen e këtyre caqeve në zbatim të planeve të veprimit për efijencë të energjisë, zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe masat tjera të efijencës së energjisë, ndërsa Neni 6 - Planet Komunale të Veprimit për Efijencë të Energjisë, përcaktojnë format dhe mënyrat e raportimit të komunave kudnrejt Qeverisë në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e planeve komunale për efijencë të energjisë. Gjithashtu Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 09/ 2017 për Zyrat Komunale të Energjisë si akt nënligjor, rregullon pozitën dhe detyrat e zyrove komunale të energjisë.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis i Vitisë 2016-2020, parasheh në objektivin e parë: Përmirësimi i gjendjes në mjedis dhe mbrojtja e shëndetit të popullates përmes rritjes së sipërfaqeve të gjelbëruara, rivitalizimi i deponive dhe promovimi i ndërgjegjësimit publik për përgjegjësin e mbrojtjes së mjedisit, rritja e mbrojtjes së publikut dhe investimet e nevojshme edukimi mjedisor, ndryshimet klimatike, pyjet zhvillimii mjedisit të paster dhe i pranushëm.

Plani Komunal i Efijencës se Energjisë 2014-2020 (PKEE) është realizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Efijencën e Energjisë 04 / L-016 dhe paraqet dokumentin e parë ligjor te Komunës i cili është përqendruar në adresimin e energjisë, efijencën e energjisë dhe zvogëlimin e CO2 brenda nivelit lokal. Plani shpreh angazhimin e qartë se si plani komunal funksionon në çështjet e energjisë, ndryshimet klimatike në përgjithësi, dhe efikasitetin e energjisë në veçanti. PKEE adreson konsumin e energjisë në

ndërtesat komunale dhe ndriçimin e rrugëve. Ai i paraqet fushat të cilat do të ndikohen si: potencialin për kursime në stokun e ndërtesave publike komunale duke përfshirë edhe ndriçimin publik, kjo po ashtu përfshinë edhe koston e investimeve, planin e zbatimit dhe kursimet e vlerësuara potencial si dhe liston projekte për realizimin e caqeve.

2.7. PËRVOJA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË

Komuna e Vitisë cdo vit bën renovimin e ndërtesave publike në juridiksion të saj duke përmirësuar mbështjellësin dhe sistemet e ngrohjes dhe ndriçimin.

Gjithashtu në baza vjetore komuna ndan mjete për ndriçimin publik të ri por edhe përmirësimin e ekzistuesit:

2.7.1. KAPACITETET PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE

Administrata komunale është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha detyrave ekzekutive të caktuara nga statuti dhe aktet e tjera normative komunale. Vendimet mirren në Asamblenë komunale. Komuna e Vitisë ka emëruar menaxherin për efiçiençë të energjisë që do të shërbejë si koordinator me sektorët përkatës varësisht prej sektorit në të cilin realizohet projekti. Me krijimin dhe funksionalizimin e sistemit komunal për menaxhimin e energjisë dhe me vendosjen e të dhënave në softverin ENMASOFT, Menaxheri komunal i energjisë do të ketë më të lehtë menaxhimin e të dhënave nga terreni për ndërtesat komunale dhe ndriçimin publik, si dhe në krijimin e Planit Komunal të Veprimit për Efiçiençë të Energjisë (PKVEE).

Ky është një mjet lehtësimi për realizimin e projekteve për EE nëpërmjet identifikimit më të lehtë të potencialit të kursimit si dhe përdorimit të këtyre të dhënave me sektorët tjerë relevantë

3. FURNIZIMI ME ENERGJI, PRODHIMI DHE DISTRIBUIMI

3.1. FURNIZIMI ME ENERGJI

Sa i përket godinave në pronësi komunale, komuna ka përgjegjësinë për ngrohje, ndriçim dhe pajisje administrative. Sektori i banimit është shumë i rëndësishëm dhe jetësor për komunën, megjithatë komunat nuk kanë përgjegjësi për menaxhimin e energjisë në këto ndërtesa. Kompania për furnizimin e shpërndarjes së energjisë elektrike (KEDS) është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të energjisë elektrike në këtë komunë, megjithatë, konsumi i energjisë dhe shërbimet e tjera të lidhura me energji janë jashtë juridiksionit komunal.

Një sistem i mundshëm i ngrohjes qendrore në qytet do të zvogëlonte dukshëm konsumin e energjisë si në sektorin publik edhe privat në komunë.

Sektori i energjisë elektrike i ekonomive familjare dhe ndërtesave publike është një nga sektorët e rëndësishëm të konsumimit të energjisë në Komunën e Vitisë. Rëndësia e saj është theksuar nga fakti se konsumon sasi të mëdha të energjisë elektrike dhe lëndës djegëse, e cila ka kontribuar në krizën aktuale të rëndë të energjisë në vend.

Të gjitha këto argumente do të thotë se rajoni ka nevojë për konsum më të lartë të energjisë sesa pjesët e tjera të Kosovës, në sektorët e ekonomive familjare dhe publike.

Përdorimi në rritje i pajisjeve elektrike, mungesa e lëndës djegëse të drurit dhe çështje të tjera të lidhura, si qasja dhe çmimet, janë shqetësuese dhe mund të shkaktojnë probleme të mëtejshme në të ardhmen. Situata shkon e përkeqësohet nga prerjet e pakontrolluara të lëndës djegëse në zonat rurale. Kjo ndikon në nivelin dhe strukturën e furnizimit total të energjisë për këtë rajon.

Tani për tani, popullsia në Komunën e Vitisë ka përdorur më së shumti drurin si lëndë djegëse për ngrohjen e hapësirës.

Në Tabela 6 janë paraqitur sasitë e shpenzuara të burimeve të ndryshme të energjisë për sektorin e ndërtesave në Komunën e Vitisë mesatarja e tri viteve të fundit:

Tabela 6 - Sasia e energjisë së konsumuar sipas burimeve energjetike mesatare 3 vite në sektorin e ndërtesave

Sektori/njesi	Dru	Thëngjill	Pelet	Naftë	Energji elektrike
	m ³	ton	ton	litra	MWh/vit
Administrata				4000	167916
Arsimi	2865				452315
Shendetesi	370				49137
Kulture					18123
Gjithsej njesi	3235	0	0	4000	687491
Gjithsej MWh/vit	5370.1	0	0	43.2	687.49

3.1.1. ENERGJIA ELEKTRIKE

Energjia elektrike është burimi i dytë më shumë i përdorur. Sikur përdoruesit individualë ashtu edhe kolektivë si Komuna e përdorin energjinë elektrike për pajisje, ngrohje, ndriçim dhe të ngjashme. Konsumi i energjisë elektrike për vitin 2018 në sektorin e ndërtesave komunale ishte 847MWh/vit ose 13% e konsumit total të energjisë. n.

3.1.1.1. FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Furnizimi me energji elektrike bëhet nga kompanitë energjetike KOSTT (kompani publike) dhe KEDS (kompani e privatizuar). KOSTT-i që manaxhon me linjat e tensioneve të larta të transmetimit të energjisë në nivelet e tensionit 110kV, 220kV dhe 400kV, ndërsa KEDS menaxhon furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike si dhe mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë në nivelet e tensionit 35kV, 10kV dhe 0.4kV.

2. NS 35/10 kV Klllokoti me fuqi të instaluar 2x8 MVA, me ngarkesë maksimale në muajin Dhjetor 2014 14.3 MW dhe harxhim mujor 6,621,023 kWh. Nga ky nëstacion bëhet furnizimi i pjesës tjetër të konsumatorëve nëpërmjet 8 linjave 10 kV: Pozharani, Sllatina, Klllokoti-Skifteraj, Terpeza, Industriali, Vineksi, Jeta dhe Stacionari. Këto linja 10 kV janë të shpërndara nëpër qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunës së Vitisë, e që në fund energjia e distribuar të konsumatorët transformohet në nivelin 400V nëpërmes trafostacioneve distributive 10(20)/0.4kV.⁷

3.1.1.2. DISTRIBUIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Komuna e Vitisë me rrethinë furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni NS 110/35/10 kV Vitia, nëpërmes dy linjave 110kV, njëra linjë nga NS 110/35/10kV Gjilani 1 dhe tjetra nga NS 110/0.6 kV Sharr-Cemi. Nënstacioni NS 110/35/10 kV Vitia ka kapacitet transformues prej 2x20 MW, me ngarkesë maksimale 26.7MW, nga i cili furnizohen me energji elektrike dy nënstacione:

1. NS 35/10 kV Rrafshina me fuqi të instaluar 2x8MVA, furnizohet nga nënstacioni NS 110/35/10 kV Rrafshina me kapacitet transformues prej 2x20 MW, me ngarkesë maksimale në

muajin Dhjetor 2014 prej 11MW dhe harxhim mujor 4,639,000 kWh. Nga ky nënstacion bëhet furnizimi i konsumatorëve të komunës së Vitisë nëpërmjet 6 linjave 10kV: Vitia, Begunca, Stublla, Germova, Smira dhe Binqa.

3.1.2. DERIVATET E NAFTËS

3.1.2.1. NAFTA

Në bazë të dhënave, Derivati i vetëm që është përdorur në Komunën e Vitisë është Nafta me 4,000 l/vit per ngrohje te ndërtesave . Nafta gjithashtu perdoret edhe për transport nga automjetet e flotes komunale.

3.1.2.2. BENZINA

⁷ PKEE Viti 2016-2020

Përdoret vetëm në transport.

3.1.2.3. MAZUT

Nuk përdoret.

3.1.2.4. LPG

Nuk përdoret në sasi të konsiderueshme.

3.1.3. THËNGJILLI

Thëngjilli është burim i energjisë për ngrohjen e ndërtesave komunale. Në bazë të dhënave konsumi i i thëngjillit rezulton me 129.00t në vitin 2018 ose 278.85MWh/vit duke marrë pjesë me 3% në konsumin e përgjithshëm për ndërtesa komunale dhe me mesataren për tri vitet e fundit 462 MWh/vit. **Në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr.06/74 të dt.06.11.2018 i ndalohej përdorimi i thëngjillit për ngrohje të objekteve të institucioneve publike.**

3.1.4. BIOMASË DRURI

3.1.4.1. DRU ZJARRI

Sa i përket biomasës, në Viti përdoret më së shumti dru zjarri me 50,479 m² të ngrohura me dru zjarri dhe 3135 m³ dru për ngrohje. Rrjedhimisht drutë e zjarrit janë burimi më i përdorshëm nga të gjitha burimet e tjera të energjisë.

Në mungesë të hapësirës për deponim dhe tharje të druve, ata përdoren të sapo prerë. Djegia e drurit të sapo prerë, i cili ka përmbajtje të lartë lagështie, ka disa aspekte negative të cilat ndikojnë në parametrat operativë të sistemit të ngrohjes:

Aspekte teknologjike - lagështia në dru pakëson temperaturën e procesit të djegies, gjë që bënë kushte të favorshme për formimin e fundrrinës së karbonizuar. Kjo masë tenton të vendoset në sipërfaqet e shkëmbimit të nxehtësisë, gjë që redukton efikasitetin e bojlerit;

Aspektet mjedisore - ekziston rreziku i lartë i formimit të benzopirenit kancerogjenik në furrë, i cili nëpërmjet ajrit mund të hyjë në sistemin respirator të njeriut. Kjo mund të ndodhë në rastin e mjegullës ose nëse rezervuari është me diametër shumë të madh dhe shkarkimet nuk mund të shpërndahen në shtresat më të larta të atmosferës;

Aspekti ekonomik - gjithë përmbajtja e lagështirës e cila është në dru, duhet të avullohet para se të fillojë procesi i djegies. Për të zhdukur 1 kg ujë, ajo merr rreth 2500 kJ energji të ngrohjes, e cila më pas ka kaluar në mjedis. Për të avulluar lagështinë nga druri, nevojitet energji shtesë e cila është humbje e burimeve.

Prandaj, një nga aspektet që ndikon në masë të madhe në fazën e prodhimit të energjisë së ngrohjes është përcaktimi i kërkesës së kualitetit adekuat për biomasë gjatë procedurës së prokurimit.

Për shembull kriteret minimale për copë druri duhet të jenë;

- përmbajtja e hirit nën 7%;
- përmbajtja e lagështirës nën 12%;

- grimca të imta nën 1%.

Parametri më i rëndësishëm i cilësisë së drurit është përmbajtja e lagështisë. Sa më i ulët është përmbajtja e lagështisë, prodhimi i energjisë për ngrohje do të jetë më i lartë, e që është për shkak të faktit, se më pak energji duhet të harxhohet për të tretur lagështinë e panevojshme. Prandaj është më se e rëndësishme të bëhet zgjidhje adekuate për ruajtjen e drurit. Opsioni i dytë është të sigurohet biomasë duke u bërë matja jo me m^3 ose t, por me përmbajtjen e saj energjetike MWh / t

3.1.4.2. PELET

Pelet nuk përdoret fare.

3.1.4.3. TJERA

Nuk aplikohen.

3.2. PRODHIMI I ENERGJISË

3.2.1. PRODHIMI I ENERGJISË PREJ BURIMEVE TË RIPËRTRITSHME (PANELE DIELLORE FOTOVOLTAIKE, PANELE DIELLORE TERMALE, POMPA TË NXEHTËSISË, ERA)

Aktualisht nuk ka impiante prodhuese për energjinë nga burimet e ripërtëritshme. Energjia nga burime të ripërtëritshme i takon të ardhmes. Shumë të rralla janë rastet kur në shtëpi individuale instalohen panelet solare që përdoren për ngrohje qendrore si dhe ngrohje të ujit sanitar. Në auditimet e bëra, sidomos në shkollat rekomandohen si masë për kursim të energjisë për ngrohje. Po ashtu edhe nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare dhe Spitale, Panelet solare do të ndikonin në reduktimin e përdorimit të energjisë elektrike ose të burimeve tjera më pak të pastërta për ngrohje

3.2.2. PRODHIMI I ENERGJISË PËR NGROHJE QENDRORE TE QYTETIT

Komuna e Vitisë nuk ka sistem qendror për ngrohje në nivel të qytetit. Ngrohja në ndërtesat.

3.3. PRODHIMI I ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

3.3.1. PRODHIMI I ENERGJISË NË EKONOMITË FAMILJARE (NDËRTESTAT E BANIMIT)

Sektori i ndërtesave të banimit është një nga konsumatorët më të mëdhenj të energjisë në Kosovë. Megjithatë, nuk ka asnjë instrument në nivel lokal për të adresuar çështjet që lidhen me eficiencën e energjisë apo BRE.

Bazuar në rezultatet e CENSUS 2011, pothuajse çdo familje në Kosovë zotëron shtëpinë e saj dhe marrja me qira e shtëpive është shumë e rrallë (2-3%). Pothuajse të gjitha banesat (99%) janë të elektrifikuara, por siç u tha më lart, lënda e drurit është burimi më i përdorur për ngrohjen e hapësirës, veçanërisht në zonat rurale.

Në Kosovë 36% e shtëpive kanë izolim termik ndërsa 47% kanë dritare me xhama të dyfishtë.

Prodhiimi i energjisë në sektorin e banimit fokusohet në energjinë për ngrohje ku burimi kryesorë është druri i zjarrit nëpërmjet stufave të nxemjes individuale ose qendrore në nivel të ndërtesave. Përveç drurit të zjarrit në sasi të vogël shfrytëzojnë pelet e naftë. Ndërtesat e reja në raste të rralla janë duke instaluar panele solare që shfrytëzohen për energji për ngrohje qendrore dhe ngrohje të ujit sanitar.

3.3.2. PRODHIMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE

Komuna e Vitisë nuk ka sistem qendror për ngrohje në nivel të qytetit. Ngrohja në ndërtesat komunale si edhe në ndërtesat private është individuale ose qendrore në nivel të ndërtesës.

3.3.2.1. PPRODHIIMI I ENERGJISË NË NDËRTESA KOMUNALE

Sipas të dhënave, janë gjithsej **60 ndërtesa publike komunale** në nën sektorin e ndërtesave në pronësi të Komunës së Vitisë dhe të përfshira në analizë, me një sipërfaqe totale të ngrohur prej **54,952m²**. Bazuar në të dhënat e komunës, këto ndërtesa konsumuan në vitin 2018:

Tabela 7. Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike

Nr.	Burimet energjetike	Konsumi sasi për vit	Konsumi MWh/vit
1	dru	3,135 m ³	4,501.8
2	nafta	4,000 l	28.8
3	energji elektrike	687,490 kWh	687.5

Për vitin 2018, duke përfshirë edhe energjinë elektrike (e cila gjithashtu mund të përdoret për ndriçim dhe pajisje elektrike), që raportohet të jetë **687 MWh**, lënda djegëse më e rëndësishme që është përdorë për ndërtesat komunale në Viti është **druri**, me një pjesëmarrje prej 86%, ndërsa energjia elektrike merr pjesë me 13% dhe me 1% merr pjesë nafta. Shih gjithashtu edhe grafikun më poshtë.




Figura 3 - Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike me përqindje

3.3.2.2. PRODHIMI I ENERGJISË NË SEKTORI KOMERCIAL, NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

Për sektorin komercial si dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme nuk ka të dhëna.

3.3.2.3. PRODHIMI I ENERGJISË NË SHËRBIMET PUBLIKE

Ndërmarrjet publike të cilat kanë zyret e tyre në komunën e Vitisë, janë Kompania rajonale e ujësjellësit dhe kompania rajonale e mbeturinave. Komuna e Vitisë nuk ka juridiksion mbi këto kompani dhe shpenizmet e tyre i mbulojnë vetë zyret respektive.

3.3.3. PRODHIMI I ENERGJISË NË INDUSTRI

Për sektorin industrial nuk ka të dhëna.

3.3.4. PRODHIMI I ENERGJISË NË BUJQËSI

Nuk ka të dhëna se sa është sasia e derivateve që përdoret gjatë një viti.

3.3.5. LËNDË TJERA PËR PRODHIMIN E ENERGJISË

Burimet tjera të energjisë nuk janë sasi që duhet konsiderohen andaj nuk ka të dhëna nëse përdoren edhe lëndë tjera djegëse për prodhimin e energjisë.

4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të energjisë në ndërtesat publike të Komunës së Vitisë u siguruan nga menaxheri i energjisë së Komunës së Vitisë. Të dhënat e energjisë janë siguruar për të gjitha ndërtesat në kuadër të komunës të grupuara në 3 sektorë si në vazhdim:

- Sektori i Ndërtesave Komunale
- Sektori i Ndriçimit Rrugor
- Flota Komunale e Automjeteve

Tabela në vazhdim tregon konsumin e energjisë për secilin sektor shprehur në MWh për vit dhe në indikator financiar si Euro për vit si mesatare e tri viteve të fundit (2018, 2017 dhe 2016)

Tabela 8 - Konsumi i energjisë sipas sektorëve, për vitin 2018

Nr.	Sektori	Konsumi MWh/vit	Konsumi EUR vit
1	Ndërtesat komunale	5,218	€ 129,800
2	Ndriçimi publik	351	€ 28,088
3	Automjetet e komunës	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna

Sipas të gjeturave më lartë del se ndërtesat publike janë shpenzuesi më i madh i energjisë në komunë me 5,218 MWh në vit.

4.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTE SAT PUBLIKE

Ndërtesat publike të cilat përbëjnë stokun e tërësishëm të ndërtesave në komunën e Vitisë janë të ndara në nënsektorët si më poshtë:

- Ndërtesa administrative,
- Ndërtesa arsimore,
- Ndërtesat e shëndetësisë dhe,
- Ndërtesa kulturore dhe sportive

Bazuar në "Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve" hartuar në nivel nacional janë marrë disa kritere për të caktuar se ku shkon energjia e konsumuar. Kjo ndihmon gjatë caktimit të përqindjes së energjisë së kursyer p.sh. në ndriçim të brendshëm etj.

Në përgjithësi energjia e konsumuar tek këto ndërtesa (nivel vendi) shkon për ngrohje, ftohje, ndriçim, ujë sanitar, pajisje administrative etj. Konsumi më i madh shkon për ngrohjen e ndërtesave⁸ me rreth 89% pasuar nga ndriçimi me 5%, pajisjet elektrike 4% dhe uji i ngrohtë sanitar, ftohje dhe gatim së bashku përmbajnë vetëm 2% të konsumit total.




Figura 5. Shpërndarja e konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave

Analiza e stokut të ndërtesave në komunën e Vitisë tregon për një tërësi ndërtesash në gjendje relativisht të mirë sa i përket aspektit termik. Kjo si rrjedhojë e renovimeve të vazhdueshme të ndërmarra nga Komuna e Vitisë si dhe ripërtëritjes së stokut ndërtimor duke ndërtuar godina të reja. Në tabelën më poshtë janë dhënë në formë tabelare gjendja e përgjithshme.

Tabela 9 - Gjendja fizike e stokut ndërtimor

Gjendja e nënsektorit	Administratë	Arsim	Shëndetësi	Kulturë/sport
Mure të paizoluara	7	19	5	0
Dritare jo eficiente	4	3	3	0
Pa ngrohje qendrore	5	9	5	1
Gjithsej ndërtesa	10	42	9	1

Nga tabela më sipër mund të shihet se nën-sektori I arsimit është njëherit edhe konsumuesi më i madh i energjisë në sektorin e ndërtesave komunale. Në tërësi 78% e energjisë së konsumuar për ngrohje, ndriçim, ftohje, ujë të ngrohtë sanitar për nevojat e ndërtesave komunale konsumohet nga 41 ndërtesat shkollore të kësaj komune. Sektori me konsumin më të ulët është Kulturë dhe sport sepse në këto ndërtesa nuk ka aktivitet të

⁸ Burimi MZHE, Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve

përhershëm por edhe meqenëse kanë sipërfaqe relativisht të mëdha për arsye të kursimit të energjisë, ato nuk ngrohen fare.

Për analizë është rekomanduar, që ndërtesat me vlera të ulëta të konsumit specifik të energjisë, më pak se 80 kWh/m², nuk do të analizohen tutje sepse konsiderohet se këto ndërtesa vetëm se janë duke operuar në kushte optimale

INDIKATORET

Për të caktuar vlerën krahasimore mes ndërtesave duhet bazuar në indikatorë specifik. Gjatë analizës së të dhënave për komunën e Vitisë indikatorët kryesor të cilët janë përdorur janë kWh/m²vit dhe EUR/m².

Sistemi i menaxhimit të të dhënave ENMASOFT bazon kalkulimet në indikatorët teknik gjegjësisht kWh/m²vit, mirëpo për rastet kur energjia e konsumuar prodhohet nga derivate që financiarisht nuk janë të favorshëm, atëherë duhet përdorur indikatorë financiar si EUR/m².

4.1.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTE SAT ADMINISTRATIVE

Ndërtesat që hyjnë nën sektorin e administratës janë: Ndërtesat komunale që ofrojnë shërbime për qytetarët, ndërtesat komunale për administratën lokale, zyrat e komunitetit etj.

Numri i ndërtesave të Administratës komunale varion në burime të ndryshme. Tek Plani komunal për EE 2016-2020 figurojnë 12 ndërtesa të nënsektorit Administratë komunale; tek lista e ndërtesave për konsum të ujit të pijshëm figurojnë 16 ndërtesa të Administratës komunale (aty është përfshirë edhe Policia), ndërsa tek lista e ndërtesave për shpenzime të energjisë elektrike figurojnë 17 ndërtesa. Duke qenë se konsumi i energjisë elektrike dhe termikë është dhënë i plotë vetëm për 6 ndërtesa, atëherë ky është numri i ndërtesave të cilat janë marrë në shqyrtim.

Tabela më poshtë jep shpenzimet për këtë nën-sektor;

Tabela 10 - Konsumi i energjisë në ndërtesat administrative

Nr	Emri i institucionit	Sipërfaqe që ngrohet	Konsumi specifik mesatar për 3 vite	Konsumi energjisë Mesatare 3 vite
		[m ²]	kWh/m ² vit	MWh/vit
1	Drejtoria e arsimit	92	227.1	13.63
2	Enti i Gjeodisizë-Viti	321	13.4	1.61
3	Tmk Zyret-Viti (Zjarrfikset)	395	319.0	97.29
4	Qendra për punë sociale-Viti	636	105.6	67.18
5	Sherbimi i Ofiqarise-Viti	1,157	70.4	81.45

6	Objekt I partive politike-Viti	490	231.9	113.65
	E pergjithshme	3,091	121.3	374.80




Figura 4 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e administratës

4.1.2. KONSUMI I ENERGISË NË NDËRTESTAT E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Në total ka 41 ndërtesa që janë nën përgjegjësinë e departamentit të arsimit por 11 nga këto shkolla janë me konsum më të ulët se 80 kWh/m²vit. Në aspektin e ngrohjes 9 nga 41 ndërtesat nuk kanë ngrohje qendrore të instaluar përderisa 19 ndërtesa nuk janë të termoizoluara nga të cilat vetëm Shkolla në Begunce bën pjesë në ndërtesat me konsum specifik më të ulët se 80 kWh/m²vit

Si konsumatorë të energjisë ata konsumojnë mesatarisht energji vjetore prej 4,063 MWh për ngrohje dhe energji elektrike.

Tabela 11 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e nën-sektorit të arsimit

Nr	Emri i institucionit	Siperfaqe qe ngrohet	Mure te izoluara	Konsumi specifik mesatar per 3 vite	Konsumi energjisë Mesatare 3 vite
		[m²]	Po/Jo	kWh/m² vit	MWh/vit
1	Shfmu,,Halil Alidema"-Pozhoran	1,150	J	131.3	150.97
2	Shfmu,,Halil Alidema"-Qifllak	231	P	96.2	22.22
3	Shfmu,,Mirali Sejdiu"-Goshicë	350	J	217.0	75.94
4	Shfmu,,Mirali Sejdiu"-Gërmovë	1,157	P	152.7	176.70
5	Shfmu,,Skender Emerllahu"-Ramjan	754	P	71.4	53.85
6	Shfmu,,Vëllezërit Gërvalla"-Buzovik	305	P	195.7	59.68
7	Shfmu,,Vëllezërit Gërvalla"-Lubishtë	1,416	P	78.8	111.63
8	Shfmu,,Vëllezërit Gërvalla"-Podgorc	295	P	132.7	39.15
9	Shfmu,,Dëshmoret e 5 Prillit"-Smirë	2,158	P	67.1	144.85

10	Shfmu,,Njazi Rexhepi"-Trestenik	328	P	189.3	62.08
11	Shfmu,,Njazi Rexhepi"-Sllatine e Poshtme	450	J	142.8	64.24
12	Shfmu,,Njazi Rexhepi"-Sllatinë e Eperme	1,660	P	54.1	89.75
13	Shfmu,,Njazi Rexhepi"-Sllatinë e Eperme	325	J	193.9	63.02
14	Shfmu,,Njazi Rexhepi"-Sadovine e Qerkezve	417	P	79.6	33.17
15	Shmp,,Jonuz Zejnullahu"-Viti	6,512	P	47.2	307.38
16	Shfmu,,Dëshmoret e Vitisë"-Viti	4,226	P	51.8	219.04
17	Shfmu,,Dëshmoret e Vitisë"-Drobesh	328	J	235.7	77.31
18	Shfmu,,Safet Rexhepi"-Ballancë	563	P	82.2	46.27
19	Shfmu,,Hasan Alia"-Remnik	1,918	P	63.8	122.41
20	Shfmu,,Kenan Halimi"-Skifteraj	2,233	P	62.6	139.71
21	Shfmu,,28 Nëntori"-Vërban	1,425	P	45.6	64.94
22	Shfmu,,28 Nëntori"-Sodovine e Jerlive	747	J	92.4	69.03
23	Shfmu,,Bafti Haxhiu"-Viti	1,800	J	101.1	182.00
24	Shfmu,,Bafti Haxhiu"-Ramnishtë	476	P	84.0	40.00
25	Qerdhja ,,Gëzimi ynë"-Viti	622	P	164.0	102.03
26	Shmgj,,Kuvendi I Lezhës"-Viti	4,764	J	97.7	465.59
27	Shmgj,,Kuvendi I Lezhës"-Pozhoran	1,370	J	96.3	131.89
28	Shfmu,,Ndre Mjeda"-Kabash	1,224	J	113.6	139.05
29	Shfmu,,Ndre Mjeda"-Binqë	108	J	122.1	13.19
30	Shfmu,,Don Mikel Tarabulluzi"-Stubëll e Eperme	1,038	P	170.8	177.26
31	Shfmu,,Nazmi Pajaziti"-Radivojc	747	P	97.2	72.58
32	Shfmu,,Nazmi Pajaziti"-Budrikë	516	P	108.8	56.15
33	Shfmu,,Skender Emerllahu"-Fshati i ri	240	P	180.5	43.32
34	Shfmu,,Nazmi Pajaziti"-Devajë	125	J	198.6	24.83
35	Shfmu,,Ndre Mjeda"-Debelldeh	389	J	134.7	52.39
36	Shf,,Mladen Markoviq"-Binqë	138	J	109.3	15.08
37	Shfmu,,Hysen Terpeza"-Terpezë	1,294	P	129.3	167.35
38	Shfmu,,Don Mikel Tarabulluzi"-Letnicë	210	J	127.2	26.71
39	Shfmu,,Safet Rexhepi"-Zhiti	425	J	129.9	55.19
40	Shf,,Mladen Markoviq"-Viti	240	J	131.3	31.52
E pergjithshme		46175		88.0	4063.77




Figura 5. Energjia specifike në ndërtesat e nën-sektorit të arsimit

Nga ky stok i ndërtimit, disa shkolla kanë numër të vogël të nxënësve dhe nuk parashihet investim në renovimin e tyre. Këto shkolla janë si më poshtë:

Tabela 12 - Shkollat me numer te nxënësve nën 84

Shkolla	Sipërfaqe që ngrohet [m ²]	Numri i nxënësve
Shfmu, „Halil Alidema” - Qifllak	231	3
Shfmu, „Skender Emerllahu” - Ramjan	754	32
Shfmu, „Vëllezërit Gërvalla” - Podgorc	295	20

Shfmu,,Njazi Qerkezve	Rexhepi"-Sadovine e	417	82
Shfmu,,Safet Rexhepi"-Ballancë		563	67
Qerdhja ,,Gëzimi ynë"-Viti		622	70
Shfmu,,Ndre Mjeda"-Binjë		108	16
Shfmu,,Skender Emerllahu"-Fshati i ri		240	50
Shfmu,,Nazmi Pajaziti"-Devajë		125	14
Shfmu,,Ndre Mjeda"-Debelldeh		389	33
Shf,,Mladen Markoviq"-Binjë		138	8
Shfmu,,Don Mikel Tarabulluzi"-Letnicë		210	16
Shf,,Mlladen Markoviq"-Viti		240	31

4.1.3. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT E NËN-SEKTORIT TË SHËNDETËSISË

Komuna e Vitisë si qeverisje lokale është përgjegjëse vetëm për sistemin e kujdesit shëndetësor parësor, i cili përfshin qendrën kryesore të kujdesit shëndetësor familjar, qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat. Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e këtyre objekteve në komunën e Vitisë.

Tabela më poshtë tregon konsumin e energjisë në tri vitet e fundit:

Tabela 13 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e shëndetësisë

Nr	Emri i institucionit	Siperfaqe qe ngrohet	Mure te izoluara	Konsumi specifik mesatar per 3 vite	Konsumi energjisë Mesatare 3 vite
		[m ²]	Po/Jo	kWh/m ² vit	MWh/vit
1	QKMF-Viti	2,457	J	165.6	406.85
2	AMF-Begunce	116	J	103.0	6.69
3	QMF-Smirë	113	J	136.4	8.87
4	QMF-Sllatine e Eperme	155	J	101.6	7.62
5	AMF-Skifteraj	121	P	114.5	7.44
6	QMF "Nëna Terezë"-Pozhoran	940	P	73.9	69.46
7	QMF Sadovine e jerlive	116	P	107.1	10.28
8	AMF-Stubell e Eperme	115	J	59.4	6.83
9	AMF-Terpeze	160	J	103.2	8.77
1	QKMF-Viti	2,457	J	165.6	406.85
2	AMF-Begunce	116	J	103.0	6.69
3	QMF-Smirë	113	J	136.4	8.87
4	QMF-Sllatine e Eperme	155	J	101.6	7.62
5	AMF-Skifteraj	121	P	114.5	7.44
6	QMF "Nëna Terezë"-Pozhoran	940	P	73.9	69.46
7	QMF Sadovine e jerlive	116	P	107.1	10.28
8	AMF-Stubell e Eperme	115	J	59.4	6.83

E pergjithshme	4634	115.0	532.81
-----------------------	-------------	--------------	---------------

Bazuar në të dhënat për konsumin e energjisë, mesatarisht këto ndërtesa gjithsej konsumojnë energji 374.8 MWh/vit ose shprehur në konsum specifik 121.3 kWh/m² vit.

Sa i përket sistemit të ngrohjes qendrore vetëm njëra nga ndërtesat ka sistem për ngrohje qendrore me dru, ndërsa 5 ndërtesat tjera nuk kanë sisteme qendrore të ngrohjes.




Figura 6. Konsumi specifik i energjisë të ndërtesat shëndetësore

Në figuren sipër është prezantuar konsumi specifik i energjisë në ndërtesat e shëndetësisë ku QKMF në qytetin e Vitisë dhe QMF Smirë kanë konsumin e energjisë më të lartë specifik nga ndërtesat tjera. Ndërtesat e këtij sektori në përgjithësi kanë mesatarisht konsum specifik të energjisë prej 115 kWh/m² në vit.

4.1.4. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTE SAT E KULTURËS E SPORTIT

Janë vetëm tri ndërtesa të kulturës dhe sportit: Shtëpia e kultures, Biblioteka Pozharan dhe Stadiumi I qytetit .Tabela 14 prezanton konsumin e energjisë në këto ndëresa e që është mjaft i ulët sepse nuk ngrohen në tërësi.

Tabela 14 - Konsumi i energjisë në ndërtesat për kulturë e sport

Nr	Emri i institucionit	Siperfaqe qe ngrohet	Mure te izoluara	Konsumi specifik mesatar per 3 vite	Konsumi energjisë Mesatare 3 vite
		[m ²]	Po/Jo	kWh/m ² vit	MWh/vit
1	Shtëpia e Kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani"-Viti	220	P	65.8	14.48